



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E TREGJEVE DHE MASAVE RREGULLATORE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .04.2020

Lënda: Kthim Përgjigje Tuajës nr.26/1

QENDRËS RES PUBLICA

Tiranë

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.26/1 (protokolluar me nr.398, datë 10.03.2020 pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale), ju informojmë së pari se AKEP kërkon ndjesë për mungesën e përgjigjes sipas afateve ligjore të kërkesës tuaj, por duhet të theksohet se kërkesa juaj nuk ka ardhur e adresuar pranë AKEP si me anë të shërbimit postar ashtu edhe në adresën tonë të e-mailit të Koordinatorit të Informimit info@akep.al

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, AKEP vepron dhe ushtron kompetencat dhe ka si bazë, në çdo rast, me misionin për të inkurajuar konkurrencën e lirë dhe të drejtë me synim përfundimtar garantimin e të drejtave të përligjura të konsumatorit, duke pasur parasysh edhe nevojat për efikasitet në treg, investime në teknologji dhe infrastrukturë dhe inovacion në kuadër të përmirësimit të pandërprerë të rrjeteve dhe shërbimeve elektronike.

Analiza për evidentimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe vendosja ose

jo e masave rregullatore kryhet nga AKEP mbi bazën e rregullores Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, e ndryshuar, rregullore kjo e në përputhje me Rekomandimin në fuqi të Komisionit Evropian për tregjet përkatëse të dyshuara për ndërhyrje ex-ante në sektorin e komunikimeve elektronike. Rregullorja përcakton midis të tjerave një listë tregjesh për t’u analizuar nga AKEP për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT, si dhe detyrimin për të kryer testin e tre kritereve për tregjet që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të rregullores.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, AKEP në mënyrë periodike ka kryer analizat e tregu të terminimit të thirrjeve me shumicë të ofruara nga sipërmarrësit e shërbimeve celulare në përputhje edhe me praktikën e vendeve të BEREC ka bërë rishikimin duke i reduktuar gradualisht tarifat me shumicë të terminimit të thirrjeve mobile dhe fikse.

Tregu me pakicë i ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse dhe ato mobile nuk është pjesë e listës së tregjeve të rregulluara të rregullores së AKEP dhe as pjesë e Rekomandimit të Komisionit Evropian për përcaktimin e tregjeve përkatëse. Duke qenë se tregu i pakicës nuk është pjesë e listës së tregjeve të rregulluara, AKEP nuk ndërhyr në përcaktimin e tarifave me pakicë të vendosura nga sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitetet në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike me pakicë, praktikë kjo e njëjtë me atë të aplikuar nga të gjitha vendet anëtare të BEREC.

Në zbatim të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH”(Ligji) dhe Rregullores Nr.27, datë 21.09.2012, e ndryshuar, “Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” (Rregullorja), AKEP monitoron në mënyrë interaktive përmbajtjen dhe tarifat e aplikuar nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Nëse nga monitorimi i tarifave me pakicë ta aplikuar nga sipërmarrësit e shërbimeve të rrjeteve fikse dhe/ose mobile konstatohet se ka shenja abuzimi apo dyshime për shtrembërim konkurrence, atëherë AKEP adreson rastin për zgjidhje te Autoriteti i Konkurrencës sipas parashikimeve të ligjit 9121 date 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Gjithashtu, AKEP për sigurimin e përmbushjes në mënyrë sa më eficiente të objektivave rregullatore dhe zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918, lidhur me monitorimin e cilësisë së shërbimit për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, AKEP ka ngritur Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Treguesve të Cilësisë së Shërbimit (QKM-Quality of Service) e përbërë nga programe software dhe pajisje hardware duke kryer monitorimin e cilësisë së shërbimit broadband.

Për matjet e kryera janë përpiluar raportet përkatëse të cilat u dërgohen operatorëve, të cilëve u kërkohet të shprehen mbi konkluzionet dhe përfundimet e këtyre raporteve si dhe marrjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë KPI (Key Performance Indicator) si dhe mbulimin dhe përmirësimin me shërbime broadband ku gjykohet e nevojshme në zbatim të akteve ligjore e

nënligjore dhe autorizimeve përkatëse. Në vazhdim të komunikimeve me sipërmarrësit mobile, janë realizuar edhe takime pranë AKEP në nivel teknik, ku diskutohen dhe dakortësohen veprimet të cilat duhet të ndërmerren nga operatorët për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Gjatë viteve në vijim të gjitha këto të dhëna përdoren për të bërë krahasimin e ndryshimeve në cilësinë e shërbimit, të cilat azhurnohen në tabelat e raportimeve për cilësinë e shërbimit të ofruar nga operatorët. Këto raporte ju mundet t'i gjeni në faqen tonë www.akep.al.

Për kërkesa të tjera në të ardhmen për informacione të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni Koordinatorin për të Drejtat e Informimit në adresën e e-mailit info@akep.al

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,